



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.346/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Djeric dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes - përdorimi i aseteve dhe objekteve publike gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë.08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e BIRN dhe Internews Anr.346/2021 e datës 05.02.2021, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e promovimit të subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti, duke e shfrytëzuar burimet e institucioneve publike – objektit shkollor, me qëllim të përfimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.

II. Detyrohet Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 05.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.346/2021 nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se përmes rrjetit social Facebook, kandidatja për deputete nga radhët e kësaj partie Albina Lleshi ka postuar video promovuese përmes së cilës ka ftuar që të votohet madje është filmuar brenda objekteve publike përkatësisht në dy shkolla të cilat gjenden në Pejë. Parashtruesi i ankesës më tutje ka theksuar se pos tjerash kandidatja për deputet Albina Lleshi e ka paraqitur edhe arsimtarin e saj Isa Lutaj duke folur për të (kandidaten Albina Lleshi). Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullave Zgjedhore dhe Kodit të Mirësjelljes. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale dhe atë dy fotografi të videove të publikuara me mbishkrimin “Përshtypjet e familjarëve dhe miqve për kandidaten e PDK-së Albina Lleshi”.

PZAP-i, më datë 05.02.2021, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi subjektin politik PDK, për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë për përgjigje deri më datë 06.02.2021 në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.02.2021, subjekti politik PDK thekson se kandidatja Albina Lleshi paraprakisht kishte marrë leje përmes komunikimit me telefon nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Pejës për realizimin e këtij spoti (videoje promovuese) e cila ka promovuar personalitetin e saj ngase e njëjta ka mbaruar mësimet në ato shkolla dhe DKA-ja i kishte sugjeruar se mund ta realizojë këtë video promovuese pa praninë e nxënësve. Sipas subjekti politik PDK, mësimdhënësi Lataj, në këtë video ka shpjeguar personalitetin dhe cilësitë e kandidatës Albina Lleshi dhe nuk ka bërë ftesë për votim dhe se PDK i ka sugjeruar kandidatës Albina Lleshi që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat për përmirësimin dhe evitimin e shkeljes së supozuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Albina Lleshi, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, ka përdorur të punësuar në institucion shtetëror dhe publik dhe atë mësimdhënësin e saj duke postuar në rrjetin social Facebook video me thirrje promovuese për votim duke treguar numrin e subjektit dhe numrin e saj si kandidate, veprim ky që është në kundërshtim me Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët neni 35 paragrafi 2 i LZP-së i cili përcakton: “ *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shëbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik*” që në rastin konkret, personat e ekspozura në video janë shërbyes publik të punësuar në institucione publike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nuk qëndron pretendimi si në përgjigje në ankesë se kandidatja në fjalë ka marrë leje për realizimin e spotit nga organet kompetente pasi një gjë të tillë nuk e ka dëshmuar, mirëpo

shkelja nuk i referohet vetëm shfrytëzimit të hapësirës publike por edhe promovimit të subjektit në fjalë nga ana e shërbyesve publik, pasi fjalët e tyre për përshkrimin e karakteristikave të kandidates në fjalë, janë ndërlidhur me kandidaturën e saj për deputete, dhe rrjedhimisht ata janë bërë pjesë e kampanjës për thirrje për votim të saj.

Paneli me rastin e përcaktimit të lartësisë së gjobës, mori parasysh faktin se videoja e kandidates në fjalë nuk është e qasshme për publikun, andaj këto veprime të kandidates për largimin e videos janë vlerësuar veprime përmirësues e që këto kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.346/2021 më datë 08.02.2021

Kryesues i Panelit

Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZR-së.